



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:204708

Datë: 04.01.2023

Numri i dokumentit: 03822485

C.nr.1022/ 2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Mirvete Alidema dhe bashkëpunëtoreshen profesionale Valbona Abdyli, në çështjen juridike të paditësit L.M nga Gjilani, Rruga “V...F...”, nr., kundër të paditurve: E.J dhe Sh. J të dy nga Gj., Rruga “V...F...”, me objekt kontesti pengim posedimi, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 09 Dhjetor 2022 dhe dorëzimit të shpjegimeve përfundimtare më datën 16 Dhjetor 2022 ndërsa me datë 4 Janar 2023 përpiloi më shkrim këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësit L.M nga Gj..., e paraqitur kundër të paditurve: E... dhe Sh.J, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se të paditurit e kanë penguar në posedimin dhe shfrytëzimin e qetë të pronës së paluajtshme të tij, njësinë kadastrale nr. P-70403013-03123-1, dhe njësinë kadastrale në bashkëpronësi me të paditurit, P-70403013-03123-4 ZK Gjilan, ashtu që në mënyrë arbitrare të ketë depërtuar në parcelën e tij nr.3123-1 dhe i kanë uzurpuar kundërligjshëm sipërfaqen e parcelës së tij në gjerësi prej 30cm dhe në tërë gjatësinë e saj prej 12m, e po ashtu e kanë penguar paditësin në posedimin dhe shfrytëzimin e qetë dhe të fundit të të drejtës së kalimit nëpër rrugën e përbashkët e cila kalon nëpër njësinë kadastrale në bashkëpronësi nr. 3123-4 për tu kyçur në rrugën kryesore të qytetit, dhe të urdhërohen të paditurit që të ndërpresin çdo aktivitet të paligjshëm të ndërmarrë në njësinë kadastrale 3123-1 dhe 3123-4, ashtu që prona e paluajtshme në pronësi të paditësit-njësinë kadastrale numër 3123-1 ta kthejë në gjendjen e cila ka qenë para trazimit, në kuptim të kthimit të sipërfaqes së uzurpuar, të ndërpresin çdo aktivitet në njësinë kadastrale numër 3123-4, larje rrobash/enësh, përgatitje turshive-zaravate, prerje drunjtove , hedhje dhe shtyrje mbeturinash në parcelën dhe në puset e paditësit dhe paditësit t’ia lejoj të drejtën e kalimit të qetë dhe të pa penguar në rrugën e përbashkët për tu kyçur në rrugën kryesore të qytetit, dhe të detyrohen të paditurat që në të ardhmen mos ta pengojë paditësin në posedimin dhe shfrytëzimin e qetë të patundshmërive lëndore.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestuese.

A r s y e t i m i

Paditësi në kësaj gjykate me datë 06.10.2022, ka paraqitur padi me objekt kontesti pengim i posedimit. Në përmbajtjen e padisë ka theksuar se është pronar dhe shfrytëzues i qetë dhe i fundit i pronës së paluajtshme të tij, i njësisë kadastrale P-70403013-03123-1 në sipërfaqe prej 274m², dhe në shfrytëzim të qetë edhe të pronës së paluajtshme në bashkëpronësi me të paditurit të njësisë kadastrale P-70403013-03123-4 me sipërfaqe prej 114 m², me pjesëmarrje

të përbashkët në pronësi me ½ të cilën pronë të paluajtshme, ndërgjyqësit tani e disa vite e shfrytëzojnë si rrugë të përbashkët, për tu kyçur në rrugën publike të qytetit. Më tutje ka theksuar se kohët e fundit dhe konkretisht nga data 25.08.2022 edhe tani, të paditurit vëllai i tij E... dhe kunata Sh... pa ndonjë arsyeje e kanë penguar paditësin, në posedimin e qetë dhe të fundit në njësinë kadastrale të tij nr. 03123-1 sikur edhe në shfrytëzimin e qetë dhe të pa penguar të njësisë kadastrale në bashkëpronësi me të paditurit, si rrugë e përbashkët, ashtu që i padituri i parë E... pa pëlqimin dhe pa praninë e tij ka angazhuar ekspert të gjeodezisë për matjen e sipërfaqes të parcelës së tij, nr. 3123-2 dhe pas matjeve të bëra paditësi konstaton se i padituri e ka kaluar kufirin sinor/megjën/ që i ndanë parcelat e tyre, dhe ka depërtuar arbitrarisht në parcelën e paditësit në gjerësi prej 30 cm dhe në gjatësi e saj prej 12m, e po ashtu e kanë penguar në posedimin e qetë dhe të fundit të drejtës së kalimit nëpër rrugën e përbashkët e cila kalon në njësinë e tyre të përbashkët për tu kyçur në rrugën kryesore. Gjithashtu i njëjti ka kërkuar që të urdhërohen të paditurat që ta ndërpresin çdo aktivitet të paligjshëm të ndërmarrë në njësinë kadastrale 3123-1 dhe nr.3123-4 ZK Gjilan, ashtu që patundshmërinë në pronësi të paditësit ta kthejnë gjendjen e cila ka qenë para trazimit në kuptim të kthimit të sipërfaqes së uzurpuar, të ndërpresin çdo aktivitet në njësinë kadastrale nr.3123-4 larje rrobash/përgatitje turshisë, prerje drunjëve në parcelën dhe pusët e paditësit dhe paditësit t'ia lejojë të drejtën e kalimit të qetë dhe të papenguar në rrugën e përbashkët për tu kyçur në rrugën kryesore.

Në përgjigjen në padi të paditurit më datë 14.10.2022, ka theksuar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke shtuar se paditësi me vendosjen e pllakave e ka lëvizur i pari kufirin sinorë-megjën, po ashtu janë të pabazuara pretendimet e paditësit se të paditurit edhe më parë por edhe tani me intensitet të shtuar pothuajse çdo ditë e trazojnë paditësin dhe familjarët e tij në shfrytëzimin e qetë dhe të fundit të së drejtës së kalimit nëpër rrugën e përbashkët e cila kalon, nëpër njësinë kadastrale në bashkëpronësi të paditësit me të paditurin 03123-4 dhe e cila rrugë të dy familjeve i shërben për tu kyçur në rrugën kryesore, të qytetit. Më tutje ka shtuar se paditësi nuk është penguar asnjëherë ndërsa pjesa e rrugës e cila ju shërben të dy familjeve për kalim të përbashkët në pusët për tu kyçur në rrugën kryesore të qytetit e ka pastruar gjithnjë e paditura tjetër Sh.J, ndërkaq shportën e mbeturinave e ka lënë në rrugën e përbashkët, afër ballkonit së të paditurit, sidomos gjatë stinës së verës qëllimisht e ka lënë kapakun e shportës së mbeturinave hapur, me qëllim të shkaktimit të pengimit që të paditurit mos të mund të qëndrojnë në ballkonin e tyre nga kundërmimi i mbeturinave.

Lidhur me këtë çështje gjykata ka caktuar seancë gjyqësore me datën 09.12.2022, në të cilën seancë kanë qenë të pranishëm : paditësi, të paditurit dhe eksperti të gjeodezisë Artan Zeneli.

Paditësi në këtë seancë si dhe gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se : puseta e cila ka qenë e vendosur në pronën e përbashkët ka qenë nga koha kur ka qenë në jetë babai i tyre, por uji që rrjedh dhe mbeturinat që hedhë kunata e tij në pusët, kalon nëpër oborrin e tij, si dhe që pas daljes në vend shikim nga gjykata, e paditura Sh...i shkundë mbeturinat në pronën e tij, për të cilën gjykatës ia tregon fotografinë, dhe kjo ka ndodhë para 4 dite, dhe për të është pengim posedim, pastaj para 5 dite e njëjta i ka pastruar tepit në pronën e përbashkët dhe ujin e ka derdhë në pjesën e tij, e jo në pusët, sepse puseta është e ngritur më lartë, dhe nuk mund të derdhet uji lirshëm dhe për këtë ka nevojë që puseta të rregullohet në mënyrë që uji të rrjedh normal pa e penguar askush. Më tutje ka shtuar se kërkon nga gjykata që të paditurit në të ardhmen mos ta derdh ujin në pronën e tij dhe për këtë ka nevojë që puseta të rregullohet, mos të ndërmerr veprime në pronën e tyre të përbashkët që atë ta pengojë të lëvizë, mos ti shkund çarçafët e bukës apo ndonjë mbeturinë, gjithashtu ka kërkuar që prona e cila është e përbashkët të jetë vetëm për kalim e zbrazët, e jo për ti shkundur çarçafët e bukës apo veprimet me të cilat

do të pengohet gjatë kalimit, meqë të paditurit pjesën e tij e kanë betonuar, dhe e ka hap si ballkon, ndërsa pronën e përbashkët e shfrytëzon për veprimet e lartë cekura. Në fund ka shtuar se nëse të paditurit hapin pusët të re në pronën e përbashkët e cila i shërben si rrugë kalimi për në rrugën kryesore, paditësi sërish nuk do ti lejojë të paditurit që të sillen si në të kaluarën dhe ta pengojnë paditësin në shfrytëzimin e qetë të kësaj rruge, pasi që të paditurit kanë zgjidhje dhe hapësirë tjetër për ti kryer të gjitha punët shtëpiake.

I padituri i parë gjatë seancës gjyqësore dhe shpjegimeve përfundimtare ka deklaruar se paditësi i ka vendosur drunjtë për djegie, gjegjësisht në hyrjen e pronës së përbashkët, e që i ka dorëzuar edhe gjykatës një foto nga vendi i ngjarjes, e që gjykata paditësin e ka ballafaquar me fotografimin e cili ka deklaruar se është e vërtetë që i ka vendosur aty drunjtë, mirëpo atë ditë ka qenë duke i prerë dhe duke i përgatitur për dimër, por që ka lënë hapësirë për kalim. Më tutje ka shtuar se drunjtë duhet të largohen nga prona e përbashkët, dhe nuk dëshiron që të shohë asgjë në pronën e përbashkët, ashtu siç ka theksuar edhe më herët puseta është e tij por gurët mbi pusët i ka vendosur paditësi e që i ka dorëzuar gjykatës një foto, ndërsa paditësi e ka pranuar faktin që i ka vendosur gurët mbi pusët me arsyetimin se e ka parë që kunata e tij ka derdhë aty mbeturina, qaj, molla etj atëherë ai ka vendosur gurët mbi. Në fund ka shtuar se qëndron pranë deklaratave në përgjigje në padi dhe i ka propozuar gjykatës që pas vlerësimit dhe administrimit të thënieve në përgjigje në padi dhe ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë të datës 28.10.2022 kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar e gjithashtu ka kërkuar që hapësira në rrugën e përbashkët tani të mbetet e lirë dhe në shfrytëzim të papenguar nga sendet dhe njerëzit.

E paditura e dytë gjatë kësaj seance ka deklaruar se nuk është e vërtetë asgjë që ka thënë paditësi deri më tani, kërkon që paditësi të mos e pengojë duke i bërë foto në oborrin e saj, dhe është e vërtetë që ka larë më herë tepit dhe e ka përdorur pronën e përbashkët për disa punë të saj, por që ka menduar se nuk e pengon askënd, mirëpo në të ardhmen nuk do të vendos.

Me pajtimin e palëve janë lexuar të gjitha provat e administruara në procesverbalin e datës 18.10.2022.

Provat e administruara:

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave materiale: Certifikatën e pronës me nr. 03123-1 në emër të L.M; Certifikatën e pronës me nr.03123-4 në emër të L.M dhe E.J (sipas paditësit e njëjta është rrugë); Skica nga vendi i ngjarjes; 6 foto me ngjyra nga vendi i ngjarjes të dorëzuar me padi dhe 9 foto të dorëzuara në shqyrtimin gjyqësor si dhe ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë .

Nga Certifikata e pronës me nr. 03123-1 në emër të L.M, gjykata vërtetoi faktin se paditësi L.M është pronar i njësisë kadastrale 03123-1, lloj i shfrytëzimit tokë ndërtimore, oborr me sipërfaqe prej 202m², ndërsa tokë ndërtimore shtëpi në sipërfaqe prej 72m², në vendin e quajtur "V... F...", pjesa e pronës 1/1.

Nga certifikata e pronës me nr. 03123-4, gjykata vërtetoi faktin se në këtë pronë evidentohen si bashkëpronar, paditësi L.M me ½ dhe të paditurit E.J me ½, rrugë private, në sipërfaqe prej 114m².

Nga fotot me ngjyra , gjykata vërtetoi faktin se në rrugën e përbashkët të paditësit dhe të paditurit, shihen të vendosura disa dru në tokë, një dërrasë, disa gra duke përgatitur turshizarzarvate, duke pastruar kova (enë).

Nga vend shikimi i gjykatës i datës 24.10.2022, gjykata ka konstatuar se në pronën kontestuese ku pretendohet të ketë pengim posedimi nuk ka pasur të vendosur asgjë, përjashtimisht të një kolicë metalike, në të cilën kishte të vendosur material-mbetje të betonit dhe një pusët pa kapak të duhur. Gjithashtu në rrugën e përbashkët të palëve ndërgjyqës e cila ju shërben për të hyrë në shtëpitë e tyre, nuk kishte asgjë të vendosur , ndërsa në anën e djathtë ishin të vendosur disa dru për djegie por nuk paraqitnin pengesë për të lëvizur-hyrë palët ndërgjyqës nëpër shtëpitë e tyre.

Nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë e datës 31.10.2022, është vërtetuar në parcela me nr.03123-1 me sipërfaqe prej 274m², sipas gjendjes faktike në këtë parcelë, është e ndërtuar shtëpia e cila shërben për banim individual, me katësi bodrum, përdhese dhe kati 1, pjesa tjetër e parcelës shfrytëzohet si oborr, parcela kufizohet me mure në anët juglindore, jug perëndimore dhe veri perëndimore ndërsa në anën verilindore është e ngjitur me parcelën nr.3123-3, një pjesë kufizohet me objekt, objekt i cili është i ndërtuar në kuadër të parcelës nr.3123-3 dhe pjesa tjetër e cila kufizohet me rrugën private, nuk është e rrethuar me asgjë, parcela ka qasje edhe nga ana mbrapa shtëpisë. Eksperti ka konstatuar se sipas gjendjes faktike parcela nr.03123-4 me sipërfaqe prej 114m², shfrytëzohet si rrugë private e cila shërben për parcelat nr.3123-1 dhe 3123-3, ku një pjesë e kësaj rruge është e shtruar me kubëza të betonit, ndërsa pjesa tjetër e cila fillon nga ku janë të vendosura dyert nga metali është e shtruar me beton, në kuadër të kësaj parcele ndodhet puseta me dimensione 0.30m x0.30m dhe thellësi përafërsisht 0.30m, kjo pusët në terren nga ajo që është parë është pusët e kanalizimit, ndodhet në parcelën e cila shërben si rrugë private, nr.3123-4 puseta është larg kufirit të parcelës nr. 3123-1 në distancë 0.75m dhe larg kufirit të parcelës nr.3123-3 në distancë 1.50m.

Baza ligjore lidhur me këtë kërkesë gjendet në dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, konkretisht në nenin 103 “Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë” dhe nenin 113 par.1 dhe 2 “Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta. Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore”, dhe në rastin konkret e posaçërisht me daljen e gjykatës në vendngjarje ku u konstatua gjendja në terren, nuk u vërtetua se paditësi është penguar në posedim të qetë dhe të pa penguar të pronës së tij.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 480 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje referuar si LPK) “ Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përjashtohet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të posedimit të parashtrohet kërkesa për shpërbllimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit”, u kufizua vetëm në vërtetimin e gjendjes së fundit të posedimit dhe nga rezultati i gjithmbarshëm i procedurës, e sidomos me daljen e gjykatës në vendngjarje, rezultoi se nuk kemi të bëjmë me pengim posedim, prandaj vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës, bazuar në nenit 450 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Prandaj, nga të lartë cekurat duke përfshirë gjendjen faktike, dispozitat ligjore, bindjen e lirë të gjykatës dhe bazuar nënin 142 pika 3 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1022/21, më datën 1 Janar 2023**

**Gjyqtarja,
Mirvete Alidema**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, ankesa eventuale dorëzohet nëpërmjet kësaj Gjykate në ekzemplarë të mjaftueshëm.